

## Legjionaret/ Gjasula shenon golin e 10 ne Bullgari

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 04 Dhjetor 2013 22:23

---



Jurgen Gjasula ka shenuar nje tjeter gol ne Bullgari per skuadren e Liteksit. Xhani De Biazhi vazhdon ta lere menjane por mesfushori i kunderpergjigjet ne distance. Ne fitoren e Liteksit perballe Chernomorets Burgas, Gjasula ka shenuar golin e trete te takimit me 11 metersh por me pare ai kishte dhene edhe nje assist. Shqiptari ka arritur ne kuoten e 10 golave sezonale nderkohe qe ne kampionat eshte barazuar me shokun e skuadres, shqiptarin tjeter Armando Vajushin qe ka shenuar edhe ai po kaq gola. Liteksi me kete trepikesh ruan vendin e dyte ne ndjekje te Ludogorets, skuadres qe kryeson kampionatin bullgar.